



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.14, datë 20. 07. 2017

Për

“Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Elite Telecommunication sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Zj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Zj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Zj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Ina Nuellari, në mbledhjen e datës 20.07.2017, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Elite Telecommunication sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.”

BAZA LIGJORE:

1. Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (**ligji nr. 44/2015**);
3. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP;
4. Rregullore nr.18, datë 11.06.2010 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”;

5. Rregulloren 19, datë 14.06.2010 “Për aksesin dhe interkoneksionin”.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Certifikatë e konfirmimit të njoftimit nr.2015-AP-U2070-8-7/datë 13.07.2015;
- Njoftim nr.1536/1, datë 14.09.2015 “Për Caktim dhe përdorim Numeracioni”, operatorit të shërbimeve të komunikimeve elektronike, Elite Telecommunication sh.p.k;
- Njoftim nr.1536/2, datë 14.09.2015 “Për Caktim dhe përdorim Numeracioni”, operatorit të shërbimeve të komunikimeve elektronike, Elite Telecommunication sh.p.k;
- Shkresë e AKEP “Mbi caktimin e Kodit të pikës Kombëtare të Sinjalizimit (NSPC) dhe të rrugëzimit dhe të portabilitetit të numrit”, operatorit Elite Telecommunication sh.p.k dhe Anekset bashkëngjitur;
- Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr. 3934 Prot. datë 08.06.2017 “Njoftim për shkelje”;
- Shkresa e Elite Telecommunication sh.p.k. me nr.13/06 Prot. datë 19.06.2017 “Shpjegime për rritjen e trafikut nga ELITE Telecommunication sh.p.k.”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr.2934/2 Prot. datë 29.06.2017 “Njoftim për pezullimin e shërbimeve dhe zgjidhjen e Marrëveshjes së Interkoneksionit”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr.2934/3 Prot. datë 06.07.2017 “Mbi korigjimin e shkeljes, kompesimin dhe faturimin e vlerës financiare, shkaktuar nga trafiku në shkelje të MI nga ana e Elite Telecommunication sh.p.k.”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr.2934/5 Prot. datë 17.07.2017 “Në përgjigje tuajës nr.11/07 prot. datë 11.07.2017 dhe rikthimin e faturave të kundërshtuara, për shlyerjen e vlerës financiare, shkaktuar nga trafiku në shkelje të MI nga ana e Elite Telecommunication sh.p.k.”;
- Certifikatë, Elite Telecommunication sh.p.k., ISO 9001:2008;
- Certifikatë regjistrimi marke;
- E-maile mes palëve.

si dhe:

- konsiderimi i shpjegimeve të dhëna nga relatori i çështjes dhe diskutimeve në mbledhje;
- fakteve të paraqitura dhe analizës së tyre referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Sipërmarrësi Elite Telecommunications me shkresën me nr.24/07 Prot, datë 17.07.2017 (nr. 1605 Prot., i AKEP, datë 17.07.2017) “Kërkesë për zgjidhje mosmarrëveshje me Albtelecom sh.a dhe rilidhjen e menjëhershme të interkoneksionit”, ka depozituar kërkesë për zgjidhje mosmarrëveshje midis Elite Telecommunications dhe Albtelecom.

2. Në kërkesën e paraqitur, Elite Telecommunications ka paraqitur kopje të shkëmbimeve të shkresave dhe njoftimeve me Albtelecom:
 - a. Me shkresë nr.3934 Prot. datë 08.06.2017 “Njoftim për shkelje” sipërmarrësi Albtelecom sh.a nga ana e tij, thekson se në 10 muajt e fundit sipërmarrësi Elite Telecommunications nuk ka patur asnjë minutë trafik drejt rrjetit Albtelecom/Eagle Mobile dhe në periudhën nga data 30 Maj - 4 Qershor 2017 është gjeneruar një trafik i menjëhershëm dhe i konsiderueshëm. Albtelecom njofton Elite Telecommunication që është në shkelje të kushteve të MI, duke i përdorur shërbimet e interkoneksionit në kundërshtim me qëllimin për të cilin është ofruar dhe duke keqpërdorur seritë e numeracionit të autorizuar nga AKEP.
 - b. Me shkresë nr. 13/06 Prot datë 19.06.2017, sipërmarrësi Elite Telecommunication i shpjegon sipërmarrësit Albtelecom sh.a se ka shtuar në aktivitetin tregëtar dhe tregëtimin e disa produkteve si dhe ka ngritur një Call Center për shitjen e produkteve dhe trafiku është real dhe i gjeneruar nga punonjësit e Elite Telecommunication, nga numrat e caktuar nga AKEP.
 - c. Me shkresë nr.3934/2 Prot. datë 29.06.2017, sipërmarrësi Albtelecom njofton pezullimin e shërbimeve të interkoneksionit duke filluar nga data 3 Korrik , pasi Elite Telecommunications ka deshtuar të paraqes provat e kërkuara sipas MI-së, shlyerjen e detyrimit financiar për dëmin e shkaktuar dhe zgjidhjen e MI-së 3 muaj nga data e marrjes së njoftimit.
 - d. Elite Telecommunications sqaron se për shkak të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, nuk mund ti vë në dispozicion Albtelecom kontratat e abonentit dhe dokumentacione të tjera të kërkuara prej tij.
 - e. Me shkresë nr.3934/3 Prot. datë 06.07.2017, sipërmarrësi Albtelecom, për dëmin e shkaktuar si rezultat i vijimit të trafikut në shkelje nga ana e sipërmarrësit Elite Telecommunications, ka llogaritur kompesimin dhe vlerën e faturës financiare.
 - f. Me shkresë nr.3934/5 Prot. datë 17.07.2017 sipërmarrësi Albtelecom rikujton sipërmarrësin Elite Telecommunication, për likuidimin e detyrimeve financiare, në të kundërt do të zgjidh MI, 3 muaj nga data e marrjes së njoftimit, 29.06.2017.
3. Sipas shkresave të shkëmbyera midis palëve, për dijeni dhe për AKEP, Albtelecom pretendon se Elite Telecommunications kryen ndryshim të CLI të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare duke i paraqitur si thirrje kombëtare për terminim në rrjetin Albtelecom dhe se Elite Telecommunications nuk ka dhënë argumenta/prova të besueshme për dyshimin e Albtelecom.
4. Sipërmarrësi Elite Telecommunications në kërkesën e paraqitur me shkresën me nr.24/07 Prot, datë 17.07.2017 (nr. 1605 Prot., i AKEP, datë 17.07.2017) “Kërkesë për zgjidhje mosmarrëveshje me Albtelecom sh.a dhe rilidhjen e menjëhershme të interkoneksionit”, i kërkon AKEP:
 - Detyrimin e Albtelecom, me një vendim të ndërmjetëm, të rihapë/rilidhë marrëveshjen e interkoneksionit deri në hetimin e plotë të rastit dhe pretendimeve të Albtelecom. Elite Telecommunication garanton që trafiku do të jetë nga numrat e Elite Telecommunication dhe nga punonjësit e Elite Telecommunication.

- Të detyrojë Altelecom të mos gjenerojë faturë të gabuar për trafik Bypass deri në zgjidhjen e mosmarrëveshjes nga AKEP. Fatura të lëshohet për trafik kombëtar, sepse i tillë është.
 - Të zgjidhë këtë mosmarrëveshje në kohën më të shkurtër të mundshme, për arsye se dëmet ekonomike që na janë shkaktuar nga ndërprerja e interkoneksionit nga Altelecom janë shumë të mëdha dhe po llogariten çdo ditë për çështjen gjyqësore që do te hapet ndaj Altelecom, pas zgjidhjes së mosmarrëveshjes nga AKEP.
5. DZMMK dhe DRRES, pasi shqyrtuan pretendimet respektive të palëve, gjykojnë se “Kërkesa për zgjidhje mosmarrëveshje” nga ana e Elite Telecommunication është paraqitur brenda afatit, sipas kushteve formale-juridike të parashikuar në Rregulloren nr.18, datë 11.06.2010 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”. Gjithashtu objekti i mosmarrëveshjes, për të cilin AKEP është investuar, është brenda kompetencës lëndore të tij sipas parashikimeve në Rregulloren nr.18, datë 11.06.2010 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve” dhe Rregulloren 19, datë 14.06.2010 “Për aksesin dhe interkoneksionin”, neni 5, pika 9 dhe 10, si dhe Rregullores së Numeracionit, pasi mosmarrëveshja lidhet me përdorimin e numeracionit nga Elite Telecommunications dhe pretendimet e Altelecom për ndryshim/modifikim CLI nga ky operator.
6. Duke qenë se sipërmarrësit Elite Telecommunications sh.p.k. dhe Altelecom sh.a. megjithë përpjekjet e bëra, nuk kanë arritur të bien dakord për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis tyre, në zbatim të nenit 120 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, AKEP zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, në rastet kur ato lidhen me zbatimin e këtij ligji dhe të rregullave të nxjerra në zbatim të tij.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të procedurës së përcaktuar Ligjin nr.9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 114, neni 115 si dhe Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (**ligji nr. 44/2015**) neni 130 e në vijim,

V E N D O S:

1. Të fillojë procedimin administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Elite Telecommunications sh.p.k. dhe Altelecom sh.a.
2. Të ngrihet Komisioni për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjes me përbërje:

- Altin Rrapaj (Kryetar)
- Marsida Drushku (Anëtar)

- Iris Xhanaj (Anëtar)
 - Jonida Biçaku (Anëtar)
 - Esmeralda Dervishi (Anëtar)
3. Të njoftohen palët e interesuara Elite Telecommunications sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a. për fillimin e procedimit administrativ;
 4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit;
 5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Anila DENAJ
3. Ketrin TOPÇIU
4. Klarina ALLUSHI